

**MARRËVESHJE SHIT-BLERJE**

**“MALAJ LAW CONSULTING AND PARTNER” SH.P.K**

Sot në Tiranë, më datë 10.02.2022, u nënshkrua kjo Marrëveshje:

#### NGA DHE NDËRMJET

**Flladi Malaj**, shtetase shqiptare, lindur në Vlorë, me 16.01.1992. me banim në Tiranë, pajisur me letërnjoftim nr. J20116084V, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, **(në vijim, “Shitësi”)**;

- nga njëra anë -

DHE

**Fatjon Malaj**, shtetase shqiptare, lindur në Vlorë, me 10.04.1983 me banim në Tiranë, pajisur me letërnjoftim nr. I30410055K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, **(në vijim, “Blerësi”)**;

#### MEQENËSE:

- Më 07/12/2021 është themeluar rregullisht shoqëria **Shoqëria MALAJ LAW CONSULTING AND PARTNER Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi te kufizuar, regjistruar më datë 06/01/2022, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me seli pranë Njesisë Administrative Nr. 5, Rruga "Abdyl Frashëri", Nd.7, Kati 3, Tiranë., Tiranë, Shqipëri, me **NIPT M21306038C**, sipas ekstraktit elektronik të regjistrimit tregtar marrë nga faqja zyrtare e QKB, (në vijim, “Shoqëria”);
- Shitësi zotëron 1 (një) Kuote e cila përfaqëson 9,9% (nëntë,nëntë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
- Shitësi ka shprehur qëllimin e tij për shitjen e pjeshme të Kuotës që zotëron në kapitalin e Shoqërisë dhe të transferojë të drejtat e pronësisë në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj Marrëveshje;
- Blerësi ka shprehur qëllimin e tij për blerjen e e pjeshme Kuotës së Shitësit në kapitalin e Shoqërisë dhe përfitimin e të drejtave të pronësisë në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj Marrëveshje;
- Shitësi dhe Blerësi vendosin në vijim, në mënyrë të detajuar afatet dhe kushtet e shit-blerjes së Kuotës në kapitalin e Shoqërisë.


**ATËHERË**, në vijim të Parashtrimeve, të cilat përbëjnë një pjesë integrale, thelbësore dhe detyruese të kësaj Marrëveshje dhe mbi bazën e premtimeve, angazhimeve, deklarimeve dhe garancive, detyrimeve dhe kushteve respektive të kësaj Marrëveshje, Palët premtojnë dhe bien dakord për sa vijon.

#### NENI I

#### PARASHTRIMET, ANEKSET DHE PERKUFIZIMET

##### 1.1 Parashtrimet

Parashtrimet e lartpërmendura përbëjnë pjesë integrale dhe thelbësore të kësaj Marrëveshje.



## 1.2 Përkufizimet

Përveç përkufizimeve që përmban kjo Marrëveshje në brendësi të saj, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin që vijon:

“**ALL**” nënkupton Lekë Shqiptar, monedha aktualisht në përdorim në Republikën e Shqipërisë;

“**Çmimi i Blerjes**” ka kuptimin e përcaktuar në nenin 2.2;

“**Data e Marrëveshjes**” nënkupton datën në të cilën kjo Marrëveshje është nënshkruar nga Palët (pra në 10.02.2022) e cila përbën edhe datën në të cilën Marrëveshja hyn në fuqi dhe prodhon efekte të plota në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm;

“**Deklarimet dhe Garancitë**” janë deklaratimet dhe garancitë të dhëna nga Shitësit dhe Blerësit, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshje.

“**Ditë Pune**” nënkupton çdo ditë në të cilën bankat në Shqipëri janë hapur për të kryer aktivitetin e tyre;

“**Kuote**” ka kuptimin e përcaktuar në parashtrime;

“**Ligji i Zbatueshëm**” nënkupton çdo ligj, qendror apo lokal, statut, direktivë, rregullore, kod ose dekret në fuqi dhe me efekt të plotë në Republikën e Shqipërisë;

“**Mbyllja**” nënkupton transferimin e Kuotës dhe përmbushjen e të gjithë detyrimeve sipas kësaj Marrëveshje;


“**Peng**” nënkupton çdo peng, hipoteke, pretendim, barre, e drejte e uzufuktit, e drejte e refuzimit të pare, e drejta e parablerjes, servitutit, qira, e drejta e palës së tretë ose garanci të çdo lloji ose kufizime të tjera të ngjashme ose marrëveshje siguroese të çdo lloji natyre ose kufizime të ngjashme apo marrëveshje preferenciale siç mund ta kërkojë konteksti;

“**Shoqëria**” nënkupton “**MALAJ LAW CONSULTING AND PARTNER**” Sh.P.K;

“**QKB**” nënkupton Qendrën Kombëtare të Biznesit.

## 1.3 Në këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe:

- a. fjalët në njëjës do të përfshijnë shumësin dhe anasjelltas, fjalët që përfaqësojnë një gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër, dhe fjalët që përfaqësojnë çdo person do të përfshijnë çdo individ, shoqëri, partneritet, bashkim shoqërisht apo entitete apo organizata të tjera, ose nën-ndarje apo agjenci të institucioneve qeveritare apo politike;
- b. çdo Parashtrim, Nen, paragraf apo Aneks, i referohen një Parashtrimi, Neni, paragrafi apo Aneksi të kësaj Marrëveshje, dhe referimet tek kjo Marrëveshje përfshijnë Parashtrimet dhe Anekset e saj; dhe



c. Titujt e një Neni, apo Aneksi të kësaj Marrëveshje janë dhënë për qëllime qartësimi, dhe për rrjedhojë nuk përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshje, dhe nuk mund të përdoren për qëllime interpretimi.

**1.4** Gjuha e përdorur në këtë Marrëveshje do të interpretohet duke pasur parasysh kuptimin e drejtë dhe pa nënkuptuar supozimin që kushtet e kësaj Marrëveshje duhet të interpretohen në mënyrë më strikte ndaj një Pale në krahasim me Palën tjetër, me arsyetimin që dokumenti interpretohet në mënyrë më strikte ndaj Palës që e ka përgatitur atë, pasi kjo Marrëveshje konsiderohet e hartuar dhe negociuar nga përfaqësues të të dy Palëve.

## **NENI II SHITJA DHE BLERJA E KUOTES**

### **2.1 Transferimi i Kuotës**

Në përputhje dhe në zbatim të afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshje, Shitësi bie dakord ti shesë Blerësit, i cili bie dakord të blejë dhe të bëhet zotërues i 1 (një) kuote të Shitësit, e cila përfaqëson 9,9% (nëntë, nëntë për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

Kuota blihet nga Blerësi e lirë dhe pa asnjë Peng të regjistruar, për rrjedhojë nga Data e Marrëveshjes, Blerësi i jep të gjitha të drejtat që lidhen me Kuotën duke përfshirë por pa u limituar tek, e drejta e votës dhe çdo e drejtë tjetër mbi dividendin e pagueshme ose aktualisht e paguar pas Datës së Marrëveshjes, nëse ka.

### **2.2 Çmimi i Blerjes dhe afatet e pagesës**

Vlera totale e shitjes së Kuotës është 100 (njëqind) ALL, i shlyer me nënshkrimin e kësaj marrëveshje.

## **NENI III MBYLLJA**

### **3.1 Data e Mbylljes**


Mbyllja e transaksionit të transferimit të Kuotës sipas kësaj Marrëveshje do të kryhet në Datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, dhe kalon pronësia mbi Kuotën tek Blerësi, i cili ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme, për kalimin e Kuotës pranë QKB.

### **3.2 Veprimet e mbylljes dhe dorëzimet**

Në datën e Mbylljes, Palët do të kryejnë të gjithë veprimet e mëposhtme, dorëzimet, dhe formalitetet, përveç çdo veprimi tjetër që kërkohet të kryhet në Datën e Mbylljes sipas kësaj Marrëveshje.

#### *3.2.1 Veprimet e Shitësit*

Shitësi bien dakord dhe zotohen se do të:



- (i) marrë pjesë dhe votojë në mbledhjen e asamblesë së Shoqërisë për miratimin e transferimit të Kuotës dhe të kësaj Marrëveshje;
- (ii) dorëzojë Blerësit të gjithë dokumentacionin përkatës të Shoqërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në dokumentacionin ligjor, kontabël, tatimor, financiar, bankar, administrativ, korrespondencat e ndryshme, si dhe çdo dokument tjetër që i përket dhe/ose ka lidhje në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me Shoqërinë, në format të shtypur, elektronik ose tjetër, origjinal apo kopje, të ndodhur në ambientet e Shoqërisë apo jashtë saj.

### 3.2.2 Veprimet e Blerësit

Blerësi bien dakord dhe merr përsipër të paguajë Çmimin e Blerjes Shitësit sipas afatit të parashikuar në këtë Marrëveshje.

### 3.3 Dorëzimi i Dokumenteve

Brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e Mbylljes, Shitësi do ti dorëzojnë Blerësit të gjithë dokumentet e Shoqërisë siç është parashikuar në këtë Marrëveshje.

## NENI IV DEKLARIMET DHE GARANCITË E SHITËSIT

### 4.1 Deklarimet dhe garancitë e Shitësit


Shitësi jep në favor të Blerësit deklarimet dhe garancitë si vijon të cilat janë dhe do të jenë të vërteta, të drejta dhe korrekte duke filluar nga data e Mbylljes, duke përjashtuar ato deklarime dhe garanci të cilat në mënyrë të shprehur i referohen një date të specifikuar dhe duhet të konsiderohen të vërteta, të drejta dhe korrekte ekskluzivisht për atë datë specifike.

Shitësi njeh dhe bie dakord se:

- a. Shitësi jep vetëm deklarimet dhe garancitë e parashikuara në këtë nen të Marrëveshjes dhe asgjë tjetër; dhe
- b. Deklarimet dhe garancitë e parashikuara në këtë nen të Marrëveshjes zëvendësojnë çdo lloj garancie apo zgjidhje tjetër që parashikohet nga legjislacioni Shqiptar në rastin e marrëveshjeve të shit-blerjeve dhe përbën të vetmin burim përgjegjësie të Shitësit për detyrimet që ka marrë përsipër sipas kësaj Marrëveshje kundrejt Blerësit; për rrjedhojë Blerësit heqin dorë nga çdo veprim apo zgjidhje që mund t'i jap të drejtë të kërkojë apo ushtojë pas datës së Mbylljes në lidhje me ato mos përmbushje, përfshirë dhe veprimin e zgjidhjes së kësaj Marrëveshje.

### 4.2 Deklarimet dhe garancitë në lidhje me Shitësin

#### 4.2.1 Aftësia e Shitësve



Shitësi kanë fuqi dhe aftësi të plotë ligjore veprimi të nënshkruajnë këtë Marrëveshje dhe të zbatojnë detyrimet e saj edhe për llogari të Shoqërisë deri në masën e përcaktuar në këtë Marrëveshje.

Shitësi kanë të gjithë të drejtat dhe autoritetin e duhur të lidhin këtë Marrëveshje dhe të përmbushin detyrimet që lindin prej saj si dhe kryejnë transaksionet që përfshihen në këtë Marrëveshje.

Të gjitha veprimet dhe formalitetet që u kërkohen Shitësit në mënyrë që të nënshkruajnë këtë Marrëveshje dhe përmbushin detyrimet e saj janë kryer menjëherë dhe rregullisht. Kjo Marrëveshje nënshkruhet nga Shitësi dhe do të jetë e detyrueshme kundrejt Shitësit në përputhje me afatet dhe detyrimet që ajo përmban.

#### *4.2.2 Asnjë konflikt*

Nënshkrimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshje nuk përbën shkelje të statutit të Shoqërisë apo ndonjë detyrimi kontraktor të tyre ose ndaj ndonjë vendimi, apo ekzekutimi dhe urdhra të lëshuara nga ndonjë autoritet kundër Shitësit që mund të ndikojë në vlefshmërinë, zbatueshmërinë dhe përmbushjen e kësaj Marrëveshje.

#### *4.2.3 Miratimi*

Nënshkrimi dhe zbatimi nga Shitësi të kësaj Marrëveshje nuk kërkon dhe nuk do të kërkojë që Shitësi të marrin ndonjë aprovim, miratim, autorizim, licencë, leje, urdhër, apo të kryejnë ndonjë depozitim, ose njoftim kundrejt ndonjë autoriteti.

#### *4.2.4 Mungesa e ndërmjetësuesve*

Shitësi nuk kanë lidhur asnjë marrëveshje dhe nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim e cila mund të ngre pretendime të palëve të treta kundrejt Blerësit për pagimin e komisioneve apo tarifave të ndërmjetësimit ose pagesa në lidhje me nënshkrimin dhe përfundimin e kësaj Marrëveshje.

### **4.3 Deklarimet dhe garancitë në lidhje me Shoqërinë**


#### *4.3.1 Themelimi dhe autoriteti i Shoqërisë*

Shoqëria është një shoqëri shqiptare e themeluar rregullisht dhe që vepron sipas ligjeve të Shqipërisë dhe nuk është objekt i ndonjë procedure falimenti apo likuidimi.

#### *4.3.2 Zotërimi i Kuotave të Shoqërisë*

Në Datën e Mbylljes, Shitësi do të ketë tërësisht, në mënyrë të pakufizuar dhe ekskluzivisht të drejtën e pronësisë mbi Kuotat, të cilat do ti transferojnë në tërësinë e tyre në favor të Blerësit pa asnjë barrë, peng, apo të drejta të palëve të treta.

#### *4.3.3 Librat dhe shënimet e Shoqërisë*



Librat dhe shënimet e Shoqërisë janë të vërteta dhe të plota në të gjithë aspektet materiale të tyre në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm.

#### 4.3.4 Statuti i Shoqërisë

Statuti në fuqi i Shoqërisë është përpiluar në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë.

### NENI V DEKLARIMET DHE GARANCITË E BLERËSIT

#### 5.1 Deklarime dhe garanci të Blerësve

Blerësit japin në favor të Shitësit deklarimet dhe garancitë e mëposhtme, të cilat janë dhe do të jenë të vërteta, të drejta dhe të sakta duke ju u referuar datës së Mbylljes, me përjashtim të atyre deklarimeve dhe garancive të cilat i referohen shprehimisht një datë të caktuar dhe duhen të konsiderohet si të drejta dhe të sakta vetëm në lidhje me atë datë.

##### 5.1.1 Aftësia e Blerësve

Blerësi kanë fuqi dhe aftësi të plotë ligjore veprimi për të nënshkruar këtë Marrëveshje dhe të zbatojnë detyrimet e saj edhe për llogari të Shoqërisë deri në masën e përcaktuar në këtë Marrëveshje.

Të gjitha veprimet dhe formalitetet që kërkohen nga Blerësi në mënyrë që kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi në mënyrë të rregullt dhe të përmbushë detyrimet e saj, janë kryer menjëherë dhe rregullisht dhe prandaj Marrëveshja do të ekzekutohet rregullisht dhe do të jetë e detyrueshme për dhe ndaj Blerësit në përputhje me kushtet dhe afatet e saj.

##### 5.1.2 Mungesa e konfliktit

Ekzekutimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshje nga Blerësi nuk do të konsiderohet shkelje e statutit të Shoqërisë, e detyrimeve kontraktore të Blerësit apo i çdo vendimi, vendimi gjyqësor apo urdhri i lëshuar nga një autoritet kundër Blerësit, i cili mund të cenojë vlefshmërinë, zbatueshmërinë dhe përmbushjen e kësaj Marrëveshje.

##### 5.1.3 Konsensusi

Ekzekutimi dhe funksionimi i kësaj Marrëveshje nga Blerësi nuk ka dhe nuk duhet të kërkojë nga Blerësi të marrë ndonjë pëlqim, miratim, autorizim, licencë, leje, urdhër, ose të bëjnë ndonjë depozitë ose njoftim te çdo autoritet.

##### 5.1.4 Mungesa e ndërmjetësve

Blerësi nuk ka lidhur asnjë marrëveshje dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim që mund të çojë në kërkimin e të drejtave apo bërjen e kërkesave të palëve të treta kundër Shitësit për

pagimin e komisioneve, tarifave të ndërmjetësimit apo pagesa në lidhje me ekzekutimin dhe funksionimin e kësaj Marrëveshje.

## **NENI VI TË NDRYSHME**

### **6.1 Marrëveshja**

Kjo Marrëveshje përcakton të gjithë marrëveshjen dhe mirëkuptimin mes Palëve në lidhje me objektin e saj dhe zëvendëson çdo marrëveshje apo deklaratë të mëparshme.

### **6.2 Ndryshimet**

Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshje nuk do të konsiderohet i vlefshëm, përveç kur është rënë dakord në mënyrë të shkruar nga Palët.

### **6.3 Përgjegjësia e ndarë**

Çdo dispozitë e kësaj Marrëveshjeje, e cila është e ndaluar ose e pa zbatueshme, do të jetë e paefektshme në masën e ndalimit dhe pa zbatueshmërisë, pa ndikuar në dispozitat e mbetura të kësaj Marrëveshje. Megjithatë, Palët marrin përsipër që të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të zëvendësuar dispozitat e pavlefshme me ato të vlefshmet, të hartuara për të arritur, sa më shumë të jetë e mundur, të njëjtat efekte ekonomike si të dispozitave të pavlefshme.

### **6.4 Heqja dorë**

Çdo tolerancë ose heqje dorë nga çdo Palë të një shkelje të një dispozite të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të konsiderohet heqje dorë e të drejtave që rrjedhin nga dispozita e shkelur ose e së drejtës për të kërkuar përmbushjen e të gjitha kushteve dhe afateve të parashikuara këtu.

### **6.5 Konfidencialiteti**

Çdo e dhënë, lajm, dokument apo informacion që lidhet me Marrëveshjen, transaksioni i parashikuar këtu, do të konsiderohen si rreptësisht private dhe konfidenciale dhe nuk do t'ju bëhen të ditur palëve të treta (përfshirë këtu QKB-ënë ose ndonjë autoritet tjetër shtetëror), pa marrë miratimin paraprak të shkruar të Palës tjetër, e cila do të bie dakord për çdo komunikim ndaj palëve të treta lidhur me transaksionin parashikuar nga Marrëveshja, pa cenuar komunikimet e detyrueshme të parashikuara nga Ligji i Zbatueshëm.

### **6.6 Transferimi i Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje dhe të drejtat që lindin prej saj, nuk mund t'i transferohen ndonjë personi ose palë të tretë nga asnjëra Palë, pa marrë paraprakisht pëlqimin e shkruar të Palës tjetër.

### **6.7 Njoftimet**

Çdo njoftim apo komunikim që do të jepet në zbatim të kësaj Marrëveshje, do të bëhet me shkrim në gjuhën shqipe dhe dorëzohet me poste të regjistruar me kthim përgjigje duke e dërguar



paraprakisht me e-mail në adresën të cilën Pala i ka komunikuar Palës tjetër në përputhje me këtë nen.

#### **6.9 Ligji i Zbatueshëm**

Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në bazë të Ligjit të Zbatueshëm, i cili është legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.

#### **6.10 Gjuha**


Kjo Marrëveshje është përpiluar në gjuhën shqipe dhe nënshkruar nga Palët në 2 (dy) kopje origjinale.

#### **6.11 Zgjidhja e konflikteve**

Të gjitha konfliktet që lindin nga apo në përputhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhen fillimisht drejtpërdrejtë me mirëkuptim mes Palëve dhe në rast se Palët nuk bien dakord brenda 30 (tridhjetë) ditëve, konfliktet do të zgjidhen nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shqipëri.

**SHITËSI**

**Flladi Malaj**

*Flladi Malaj*  


**BLERËSI**

**Fatjon Malaj**

*Fatjon Malaj*  
